

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Shërbim mirëmbajtje për impiantet e ngrohjes dhe rrjetet e furnizimit me ujë të pijshëm.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

CPV: 44621220-7 kaldata me ngrohje qendrore

VLERA E FONDIT LIMIT: 33 333 300 (tridhjetë e tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:
 - a. Sigurimin e ofertës, sipas shtojcës 3;
 - b. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DT.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të, duhet të zotërojë Liçencën Profesionale të lëshuar nga institucionet shtetërore kompetente si më poshtë:

- NP - 12 A Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 2, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4 , gërma a) e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i kategorisë së licencës që kërkohet bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Të dhënat për licencën e mësipërme janë vendosur referuar me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente. Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zërat e shërbimeve të pasqyruara në preventiv. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.1.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Çertifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht shërbime që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së.

2.1.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 14001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 pika 2 c) të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik. Kjo certifikatë është kërkuar me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të mjedisit. Kuadri ligjor që rregullon tregtimin dhe përdorimin e impianteve të ngrohje-ftohjes i kushton një rëndësi parësore mbrojtjes së mjedisit për vetë natyrën që mbartin këto produkte objekt prokurimi. Ky çertifikim ofron një kuadër praktik për shoqëritë që menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale në përputhje me

parashikimet ligjore në fuqi. Çertifikimi i operatorëve ekonomikë ofertues me Çertifikatën ISO 14001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit garanton autoritetin kontraktor për sigurinë e shërbimit të impianteve ngrohje-ftohje në të gjithë zinxhirin e furnizimit nga burimi i furnizimit deri në destinacionin e kërkuar.

2.1.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 45001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e shëndetit dhe sigurisë në punë. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. është kërkuar kjo certifikatë pasi ofron një kuadër për menaxhimin efikas të shëndetit dhe sigurisë në punë përfshirë gjithë aspektet e menaxhimit të riskut dhe të përputhshmërisë ligjore nga operatorë ekonomikë, të cilët do të ekzekutojnë këto kontrata shërbimi. Një OE i certifikuar sipas këtij standardi është në gjendje të:

- Krijojë kushtet më të mira të punës në gjithë organizatën e tij;
- Identifikojë kërcënimet dhe vendos kontrollin për menaxhimin e tyre;
- Redukton aksidentet dhe sëmundjet në vendin e punës duke minimizuar kostot dhe kohën Joproductive;
- Përfshin dhe motivon stafin me kushte më të mira dhe më të sigurt pune;
- Dëshmon përputhshmëri ndaj klientëve dhe furnitorëve;

Të gjitha këto janë garanci se OE i shpallur fitues i cili është i certifikuar sipas këtij standardi ka kapacitetet e duhura për realizuar me sukses kontratat me AK-të.

2.1.5 Organi i vlerësimit të konformitetit të certifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues të jetë i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.

Shënim: Ky kriter (2.1.5) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë *nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 pika 2 c) të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Ky kriter është vendosur në përmbushje të detyrimeve ligjore që përcaktojnë Ligji nr.116/2014, datë 11.09.2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të Konformitetit", Ligji nr.10489 datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", VKM nr. 667, datë 29.7.2015 "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit". Çertifikatat e lëshuara nga ente certifikuese të pa akredituara nuk garantojnë efikasitetin dhe sigurinë për kërkesat e cilësisë të cilat autoriteti kontraktor i kërkon për realizimin e kontratës.

2.1.6 Operatori Ekonomik ofertues duhet te disponoje “Dokumentin e Vleresimit te Rriskut (DVR)”, ne pajtim me Ligjin nr.10237, date 18.02.2010 “Për sigurine dhe Shendetin ne Pune” i ndryshuar, sipas fushes se objektit te veprimtarise. (ne rast bashkimi operatoresh ekonomike, mjafton disponueshmeria e 1 DVR per te gjithë BOE).

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 pika 4, nenin 76 pika 3 germa a) të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 5 germa c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shendetin në punë". Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me vendin e kryerjes së shërbimeve si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një mjedisi të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të njerëzve që mund të jenë prezent pranë vendit të shërbimeve. Për sa më lart, me anë të këtij çertifikimi operatori ekonomik, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që ofertuesit do të reazlizojnë shërbimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2019, 2020, 2021) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, ndërsa kushti që bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar është vendosur në zbatim të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”i ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2.2.2 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2019, 2020, 2021) të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Udhëzimin Nr. 7, datë 10.1.2017 “Për disa shtesa në Udhëzimin Nr. 24, datë 2.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar). Në përcaktimin e këtij kriteri është mbajtur në vëmendje neni 29 i Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” (të ndryshuar), ku citohet“Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.... Përcaktimi i vlerës së kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2022 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2022 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer shërbime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; a) Kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe shërbimet e realizuara ose vërtetimin për realizimin me sukses të kontratës shoqëruar me faturat tatimore të shitjes, ku të shprehen qartë datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. b) Për shërbime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 47 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është bazuar në nenin 41, pika 3 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i operatorit ekonomik ofertues), Personin Përgjegjës për kryerjen e shërbimeve (me profesion inxhinier mekanik/elektrik/ hidroteknik/elektronik) të punimeve në objekte, i cili duhet të figurojë në listëpagesën e subjektit për periudhën Nëntor 2022 - Dhjetor 2022 dhe në vazhdim, dhe të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë pune e vlefshme, Diplomë.
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Nëntor 2022 - Dhjetor 2022.

Shënim: Ky kriter (2.3.2) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyrës së shërbimeve që kërkohen të prokurohen siç janë shërbimet periodike për mirëmbajtjen e impianteve ngrohje-ftohje dhe rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm të objekteve arsimore është e nevojshme përcaktimi paraprakisht i Përgjegjësit për Zbatimin e Kontratës, kërkesë e cila lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e shërbimeve.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë i cili të ketë kontratë pune, diplomë, licensë Urdhër Mjeku dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues për periudhën Nëntor 2022 - Dhjetor 2022 dhe në vazhdim, ose duhet të paraqitet një kontratë e vlefshme për ofrimin e këtij shërbimi me një subjekt të licënsuar sipas ligjit. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, secili nga operatorët ekonomikë duhet ta plotësojë këtë kusht sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Shënim: Ky kriter (2.3.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 3, pika 3, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Ligjin Nr.10237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” (i ndryshuar), Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 692, datë 13.12.2001 “Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë” (i ndryshuar) i cili përcakton..... "2/1. Punëdhënësi siguron funksionimin e shërbimit mjekësor, nëpërmjet mjekut të ndërmarrjes, në të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari prodhuese, private ose shtetërore, vendase ose të huaja, juridike ose fizike.... dhe.....12/2. Për subjektet që nuk përfshihen në pikën 12/1 të këtij vendimi, marrja në punë e mjekut të ndërmarrjes është e detyrueshme për ato ndërmarrje, ku numri i të punësuarve është jo më pak se 15 punonjës.... Mjeku i ndërmarrjes ofron këshillimin e tij për problemet e mbrojtjes në punë, për shmangien e aksidenteve dhe të sëmundjeve profesionale, si dhe për të gjitha çështjet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë. Ai vlerëson çështje të fiziologjisë së punës, të problemeve higjienike e sanitare, veçanërisht të ritmit e të kohës së punës, të organizimit të vendit të punës, të zhvillimit dhe të mjediseve të punës.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një dëshmi nga administrata tatimore për punësimin mesatar të jo më pak se 17 (shtatëmbëdhjetë) punonjësve për periudhën Nëntor 2022 - Dhjetor 2022 dhe në vazhdim, të vërtetuar me dokumentacionin si vijon;

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Nëntor 2022 - Dhjetor 2022.
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislati në fuqi për periudhën Nëntor 2022 - Dhjetor 2022.

Shënim: Ky kriter (2.3.4) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyrës së shërbimeve që kërkohen të prokurohen siç janë shërbimet periodike për mirëmbajtjen e impianteve ngrohje-ftohje dhe rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm të objekteve arsimore është e nevojshme përcaktimi i një numri minimal punonjësish që duhet të ketë operatori ekonomik për zbatimin e kontratës, kërkesë e cila lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e shërbimeve.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës, të pajisur me diploma/çertifikata/dëshmi kualifikimi profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara/ liçensuara ose ekuivalente si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Nëntor 2022 - Dhjetor 2022 dhe në vazhdim, minimumi:

- 6 (gjashtë) Punonjës /Specialiste per impjante ngrohje ftohje
- 4 (kater) Teknik/ hidraulik
- 2 (dy) Teknik/elektricit
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Inxhinier Elektronik/Informaticien
- 1 (një) specialist te çertifikuar/trajnuar nga prodhuesi i Sistemit DMD – Diagnostic Monitoring Device

Për këta punonjës, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjisllacioni në fuqi për periudhën Nëntor 2022 - Dhjetor 2022.
- Kontratën individuale të punës të vlefshme;
- Dokumentacionin që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar në këtë kriter. (diplomë/çertifikatë/dëshmi kualifikimi profesional).

Shënim: Ky kriter (2.3.5) do të konsiderohet i përbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetedeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Për sa i përket përcaktimit të punonjësve të kualifikuar dhe të pajisur me diploma/çertifikata/dëshmi kualifikimi profesional kjo kërkesë del e nevojshme nga shqyrtimi i prevetivit të pasqyruar ku sasia dhe lloji i shërbimeve e bëjnë të domosdoshëm vendosjen e këtij kriteri në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

- a) 6 (gjashtë) Punonjës /Specialiste per impjante ngrohje ftohje të kualifikuar janë vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së shërbimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës dhe shpërndarjen e fuqisë punëtore njëkohësisht në objekte të ndryshme me largësi të konsiderueshme nga njëri-tjetri, është gjykuar që të paktën 2 (dy) punonjës /Specialiste per impjante ngrohje ftohje të kualifikuar duhet të jenë të pranishëm në çdo objekt.
- b) 4 (katër) Teknikë/ hidraulikë të kualifikuar janë vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së shërbimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës dhe shpërndarjen e fuqisë punëtore njëkohësisht në objekte të ndryshme, dhe disa zëra të veçantë të preventivit realizimi i të cilave kërkon staf të specializuar është gjykuar që të paktën 1 (një) ose 2 (dy) Teknikë/ hidraulikë të kualifikuar duhet të jenë të pranishëm në çdo objekt ku janë të nevojshëm për kryerjen e shërbimeve specifike.
- c) 2 (dy) Teknikë/elektracistë të kualifikuar janë vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së shërbimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës dhe shpërndarjen e fuqisë punëtore njëkohësisht në objekte të ndryshme, është gjykuar që të paktën 1 (një) Teknik/elektracist i kualifikuar duhet të jetë i pranishëm në çdo objekt.
- d) Kërkesat për inxhinierët hidroteknik, elektrik, mekanik dhe elektronik/informaticien për kryerjen e shërbimeve në objektet arsimore është e diktuar nga nevoja reale dhe përvoja e realizimit të kontratave të mëparshme të ngjashme. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të shërbimeve. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit. Janë kërkuar inxhinierët e mësipërm për zbatimin e shërbimeve në përputhje me zërat e pasqyruara të preventivit, termave të referencës dhe specifikimeve teknike që do të zbatohen dhe si dhe kategorive përkatëse në licencën përkatëse të zbatimit. Inxhinierët e kërkuar janë përgjegjës për zbatimin e saktë të preventivit për secilin nga zërat e shërbimeve dhe për cilësinë e materialeve që vendosen në objektet ku do të kryhen shërbimet për faktin që natyra e shërbimeve, për zërat kryesore të preventivit është e lidhur drejtpërdrejt me kualifikimin profesional të inxhinierëve të kërkuar, prandaj rezulton se duhet patjetër që realizimi me cilësi dhe në kohë i shërbimeve të realizohet dhe monitorohet specialistë të kualifikuar.
- e) 1 (një) specialist te çertifikuar/trajnuar nga prodhuesi i Sistemit DMD – Diagnostic Monitoring Device është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyrën e shpërndarjes së shërbimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës dhe përcaktimin e në preventivin e parashikuar të shërbimit KREU G “*Impianti Kontrollit dhe monitorimit DMD (Diagnostic Monitoring Device)*”, shpërndarjen e këtij shërbimi njëkohësisht në objekte të ndryshme, dhe disa zëra të veçantë të preventivit realizimi i të cilave kërkon staf të specializuar është gjykuar që të paktën 1 (një) specialist te çertifikuar/trajnuar nga prodhuesi i Sistemit DMD – Diagnostic Monitoring Device duhet të jetë i pranishëm në funksion të zbatimit të kontratës.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë furnizimi nga prodhuesi/distributori të autorizuar, për këtë procedurë prokurimi (objekt, nr.REF), ose autorizim prodhuesi/distributori zyrtar për mallrat që do të përdoren në realizimin e objektit të prokurimit (pompa, bruçator, enë zgjerimi, galixhant elektrik, Impianti i kontrollit komandimit dhe monitorimit ne distance DMD (Diagnostic Monitoring Device). Në rast paraqitje deklaratë furnizimi/autorizim distributori, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një akt marrëveshje/bashkëpunimi të vlefshme, midis prodhuesit dhe distributorit ose çdo akt tjetër që prodhuesi i një produkti i jep të drejtën e tregëtimit një kompanie tjetër. Deklarata e furnizimit/autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Shënim: Ky kriter (2.3.6) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri AK gjykon se deklarata e furnizimit e prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i garantuar për ofrimin tek Autoriteti Kontraktor të këtyre mallrave që do të përdoren në shërbimet e planifikuara. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave objekt prokurimi të cilat kërkohen që të jenë prodhuar në përputhje me standardet dhe cilësitë e kërkuara në DST. Kjo deklaratë furnizimi kërkohet nga autoriteti kontraktor vetëm për mallrat të cilat mbajnë peshën kryesore në zërat e nevojshëm për kryerjen e shërbimeve sipas parashikimeve të pasqyruara në DST. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës pasi sasia e produkteve që do të përdoren është e konsiderueshme.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues për mallrat që do të përdoren në realizimin e objektit të prokurimit (pompa, bruçator, enë zgjerimi, galixhant elektrik, Impianti i kontrollit komandimit dhe monitorimit ne distance DMD (Diagnostic Monitoring Device), të pasqyruara në Shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike”, duhet të paraqesë: Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve të mallrave, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të mallrave sipas kërkesave të DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse mallrat e ofruara të cilat do të përdoren në kryerjen e shërbimeve, plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të

Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave të cilat janë të domosdoshme në realizimin e shërbimeve objekt prokurimi. Në këtë rast është shumë e rëndësishme plotësimi i specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor pasi kemi të bëjmë me produkte të cilat domosdoshmërisht duhet të garantojnë cilësinë e kërkuar dhe funksionalitetin gjatë përdorimit të tyre në kryerjen e punimeve të ndryshme specifike pasi përdoren në objekte arsimore ku kërkesat e cilësisë dhe të ruajtjes së mjedisit janë të larta.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi për të cilat kërkohen shprehimisht standarte teknike kombëtare ose ndërkombëtare të publikuara dhe të pasqyruara në Shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike”, duhet të paraqesë një deklaratë konfirmimi ku konfirmon se mallrat që do të përdoren në kryerjen e shërbimeve objekt të kontratës janë të çertifikuara CE, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligjit Nr.10 489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave të cilat janë të domosdoshme në realizimin e shërbimeve objekt prokurimi në përputhje me parashikimet e nenit 8 pika 4 të Ligjit Nr.10 489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” i cili shprehet se..... 4. Me hartimin e deklaratës EC të konformitetit, prodhuesi ose, sipas rastit, instaluesi merr përsipër përgjegjësinë për përputhshmërinë e produktit me kërkesat ligjore në lidhje me to. Në këtë rast është shumë e rëndësishme plotësimi i specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor pasi kemi të bëjmë me produkte të cilat domosdoshmërisht duhet të garantojnë cilësinë e kërkuar dhe funksionalitetin gjatë përdorimit të tyre në kryerjen e punimeve të ndryshme specifike pasi përdoren në objekte arsimore.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentacion për posedimin e mjeteve/ pajisjeve teknike dhe mbrojtëse në pronësi ose me qira, që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, minimumi për mjetet/ pajisjet teknike dhe mbrojtëse si më poshtë;

Nr.	Kreu I - Mjetet dhe pajisjet teknike	Sasia minimale	Gjendja
1	Automjet për transport të përzier deri në 3.5 ton	2 copë	Pronësi ose me qira
2	Automjet për transportin e stafit teknik	3 copë	Pronësi ose me qira
3	Gjenerator	1 copë	Pronësi ose me qira
4	Matrapik	3 copë	Pronësi ose me qira
5	Impiant saldimi tubacionesh bakri	1 copë	Pronësi ose me qira

6	Impiant saldimi tubacionesh hekuri	1 copë	Pronësi ose me qira
7	Rilevues për humbjet e gazit	1 copë	Pronësi ose me qira
Nr.	Kreu II - Mjetet dhe pajisjet mbrojtëse	Sasia minimale	Gjendja
1	Helmetë mbrojtëse për kokën	17 copë	Pronësi ose me qira
2	Jelekë me shirita fosforishentë	17 copë	Pronësi ose me qira
3	Kuti e Ndhmës së shpejtë	3 copë	Pronësi ose me qira

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), kurse për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet me kontrata përkatëse e qerasë/furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme).
- b) Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre si aktet e zhdoganimit/faturat tatimore të blerjes dhe kur ato janë të marra me qera të paraqitet kontrata e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj si edhe dokumentat që vërtetojnë pronësinë e qiradhënënesit si aktet e zhdoganimit/ faturat tatimore të blerjes.
- c) Mjetet, pajisjet teknike dhe mjetet mbrojtëse të mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera gjatë afatit kohor të zbatimit të kontratës objekt të këtij prokurimi. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë brenda orarit të punës, në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës, mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr.9.

Shënim: Ky kriter (2.3.9) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë shërbimet për mirëmbajtjen periodike të impianteve ngrohje- ftohje dhe rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm të objekteve arsimore, të cilat duhet të realizohen sipas specifikimeve teknike, duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, makineritë dhe pajisjet mbrojtëse të përcaktuara më sipër. Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se është çmuar si e nevojshme zotërimi i këtyre pajisjeve specifike, të konsideruar nga Autoriteti kontraktor si të domosdoshme për realizimin e shërbimeve në përputhje me ligjislacionin e punës. Referuar natyrës së objektit të prokurimit për realizimin me sukses të shërbimeve është e nevojshme pajisja e këtyre mjeteve teknike dhe pajisjeve mbrojtëse për punonjësit.

1) Automjet për transport të përzier deri në 3.5 ton për transportimin e materialeve të ndryshme që nevojiten për kryerjen e shërbimeve, është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së shërbimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës dhe shpërndarjen e objekteve arsimore në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, është gjykuar që të paktën 1 (një) mjet i tillë është i nevojshëm për zbatimin e kontratës.

2) Automjet për transportin e stafit teknik, është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së shërbimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës, sasinë e produkteve të nevojshme për realizimin e kontratës dhe shpërndarjen e 30 objekteve arsimore, është gjykuar që të paktën 1 (një) mjet i tillë është i nevojshëm për zbatimin e kontratës.

3) Gjenerator $\geq 5kw$, është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së punimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës, sasinë e materialeve dhe llojin e punimeve të parashikuar në preventiv ku është e nevojshme lidhja e mjeteve teknike montuese me energji elektrike, është gjykuar që të paktën 1(një) pajisje teknike e tillë është e nevojshme për zbatimin e kontratës pasi në raste të paparashikuara mund të ndodhë ndërprerje e energjisë elektrike dhe kjo do të sillte pasoja në përmbushjen me sukses të kontratës në afatin e parashikuar.

4) Matrapik, është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së punimeve në objekt. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës, sasinë e shërbimeve të parashikuara që do të hiqen nga objekti duke nxjerrë tabanin fillestar të betonit, është gjykuar që të paktën 3 (tre) pajisje teknike të tilla janë të nevojshme për zbatimin e kontratës.

5) Impiant saldimi tubacionesh bakri, është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së punimeve në objekt. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës, sasinë e materialeve dhe llojin e punimeve të parashikuar në preventiv ku është e nevojshme ndërhyrja teknike me një pajisje teknike të tillë, është gjykuar që të paktën 1 (një) pajisje teknike e tillë është e nevojshme për zbatimin e kontratës pasi në raste të mungesës së këtij mjeti teknik do të sillte pasoja në përmbushjen me sukses të kontratës në afatin e parashikuar.

6) Impiant saldimi tubacionesh hekuri, është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së punimeve në objekt. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës, sasinë e materialeve dhe llojin e punimeve të parashikuar në preventiv ku është e nevojshme ndërhyrja teknike me një pajisje teknike të tillë, është gjykuar që të paktën 1 (një) pajisje teknike e tillë është e nevojshme për zbatimin e kontratës pasi në raste të mungesës së këtij mjeti teknik do të sillte pasoja në përmbushjen me sukses të kontratës në afatin e parashikuar.

7) Rilevues për humbjet e gazit, është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së shërbimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në

dispozicion për realizimin e kontratës, sasinë e impianteve ngrohës-ftohës të tipit Chiller të instaluara në objekte të ndryshme, është gjykuar që të paktën 1 (një) pajisje teknike e tillë është e nevojshme për zbatimin e kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike dhe termave të referencës

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm, i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve të teknike në përputhje me nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përshkrimi dhe qëllimi i shërbimeve:

Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Tiranë ka në administrim të gjitha objektet parashkollore, shkollore dhe qendra sociale në Bashkinë Tiranë, të cilat janë të pajisura me impiante ngrohje dhe sisteme furnizimi me ujë të pijshëm. Gjëndja teknike e të tyre, në punë ose jo si dhe nevojat për riparime jepen në preventiv, ku është dhënë sasia e shërbimeve teknike dhe furnizim vendosjet në llojshmëri, sasi dhe specifikime teknike.

Këto impiante (sisteme) ngrohje kanë në shfrytëzim kaldaja me pellet ose me naftë (gazoil) si edhe soba me pellet. Në preventivin (formularin e çmimit të ofertës) total të riparim-shërbimeve janë ndarë:

- Kaldaja me pellet, të cilave do t’ju kryhen shërbime riparim-mirëmbajtëse,
- Kaldaja me naftë (gasoil), të cilave po ashtu do t’ju kryhen shërbime riparim-mirëmbajtëse.
- Soba me Pellet të cilave do t’ju kryhet shërbime për riparim-mirëmbajtje.

Fuqitë kalorifike të kaldajave janë e madhësive nga 60 - 600 kW; sprucatorët janë të tipeve të ndryshme.

Kaldajat që do të rikthehen me naftë do të kenë detyrimisht të gjitha të njëjtën markë të djegësit të lëndës djegëse-brucatorit.

Operatori ekonomik që do të kryejë shërbimet riparim-mirëmbajtëse duke zbatuar të gjitha procedurat e nevojshme për këto sisteme si: auditim (njohje) të sistemeve, Impianti i monitorimit dhe kontrollit në distance riparimet dhe shërbimet e duhura si dhe zëvendësimin e pjesëve të ndërrimit në sasi dhe cilësi për të garantuar funksionim normal të sistemeve të ngrohjes.

Saldimet do të kryhen nga saldator të patentuar për saldim pajisje nën presion me elektroda për çelik zjarrdruues dhe aparat saldimi gjenerator.

Kërkohet gjithashtu:

Nepermjet Impiantit të monitorimit dhe kontrollit në distance të bëhet diagnostikimi, menaxhimi, automatizimi i sistemit termo-hidraulik, të bëhet kontrolli i gjëndjes së manometrave të presionit, të termostateve, paneleve elektrike- elektronike të punës dhe komandimit si për sistemet e ngrohjes dhe të furnizimit me ujë të pijshëm etj.

Detyrat:

Të realizojë në kohë, sasi e me cilësi shërbimet teknike dhe riparimet e planifikuara, të cilat do të kryhen nga ora 07:30 deri në 16:30. Mund të kryhen edhe në ditë të shtuna dhe diela për të mos e penguar kryerjen e aktivitetit parashkollor dhe shkollor. Për rastet e defekteve të çastit (emergjente), riparim-shërbimet do të kryhen me marrjen e njoftimit çdo ditë.

Detyra më prioritare siç del edhe nga grafiku ose afati i kryerjes është:

Riparim-mirëmbajtje e sistemeve të ngrohjes dhe të furnizimit me ujë të pijshëm, shërbim që do të realizohet detyrimisht sipas përcaktimeve kohore të përcaktuara në grafikun e ekzekutimit të shërbimeve deri më 12 (dymbëdhjete) muaj nga nënshkrimi i kontratës.

Specifikimet teknike

Mallrat që do të përdoren për kryerjen e shërbimeve duhet të jenë të shoqëruara me garancitë përkatëse (të përcaktuara në DST dhe në kontrate) në marrëveshjen e përcaktimit të kushteve të garancisë, para lidhjes së kontratës do të definohen dhe mënyrat, koha, dhe çdo specifikim tjetër i vlefshëm dhe i detyrueshëm për palët kontraktuese. Përzgjedhja e specifikimeve teknike të bojërave dhe produkteve të tjerë të nevojshëm për realizimin e kontratës është bërë duke u bazuar tek standarti i mallrave të ofruara sipas kontratave të mëparshme gjatë viteve dhe nevojave reale të institucionit për llojin, sasinë dhe cilësinë e tyre duke patur parasysh se këto materiale përdoren në ambiente shkollore dhe parashkollore ku patjetër duhet të përmbushen standartet CE të konfirmimit për cilësinë dhe ndikimin në mjedis. Materialet do të përdoren për mirëmbajtjen e impianteve ngrohje – ftohje dhe furnizimit me ujë të pijshëm të objekteve arsimore, prandaj ato duhet të jenë ekologjike, cilësore dhe të padëmshme për shëndetin e fëmijëve.

Sipas këtyre kritereve të përcaktuara do të ishte e nevojshme që produktet e ofruara të vërtetonin përmbushjen e këtyre kritereve me anë të çertifikimit CE, pasi kjo mënyrë do të na ndihmojë të vlerësojmë për cilësinë e tyre dhe përmbushjen e normave të kërkuara. Veçanërisht pjesët e këmbimit duhet të ketë performancë të mirë dhe lehtësi në përdorim.

Për sa i përket specifikimeve të tjera teknike të vendosura për produktet që do të përdoren në kryerjen e shërbimeve, janë të përcaktuar vetëm specifikimet bazë të nevojshme me diapazon të arsyeshëm pasi në praktikë kjo ndryshon nga shumë faktorë të cilat ndikojnë në normat e përcaktuara siç janë; lloji i produktit, natyra e funksionalitetit, mënyra e aplikimit dhe destinacioni për të cilën do të përdoren. Këto përcaktime janë pothuajse në të gjitha web-sitet zyrtarë të operatorëve ekonomikë prodhues botërorë ku përcaktohet i njëjti qëndrim për standartet minimale të produkteve. Të gjitha mallrat të cilat do të lëvrohen nga operatori ekonomik fitues duhet të jenë patjetër konform ofertës teknike të ofruar dhe të depozituar duke përfshirë cilësitë teknike dhe markën e prodhuesit.

Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 5 të Dokumentave Standarte të Tenderit.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.